



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 5 (827809)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 3 shkurt 2023

PU, reparti elitë në historikun e tij 31-vjeçar

Policia Ushtarake festoi 31-vjetorin e krijimit të saj. Me këtë rast ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi do të shprehte vlerësimin e tij për këtë repart me kontribut të çmuar të Forcave të Armatosura. "Përgjatë 31 viteve të historisë së saj, Policia Ushtarake ka treguar se është një nga repartet elitë të Forcave tona të Armatosura. Ruajtja e rendit ushtarak, garantimi i zbatimit të ligjit, angazhimi në luftën kundër terrorizmit dhe pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse

e humanitare janë misioni kryesor i kësaj njësie. Mirënjohje gjithë grave dhe burrave që kanë shërbyer dhe ngritur lart emrin e Policisë Ushtarake." Policia Ushtarake e Forcave të Armatosura u formua më 1 shkurt 1992. Pas viteve '90, ashtu si në të gjithë vendin edhe në FA u kryen një sërë reformash. Ndër to: miratimi i akteve ligjore, nënligjore, si dhe ndryshime strukturore, ku pjesë e këtyre ndryshimeve ishte dhe krijimi i PU në përbërje të FA-së. Formimi

i kësaj strukture kishte si qëllim forcimin e rregullit dhe të disiplinës në FA dhe u pa si domosdoshmëri për transformimin e ushtrisë sipas standardeve të vendeve të NATO-s. Me krijimin e PU-së, objekti i punës së saj ishte kontrolli i trafikut ushtarak, ruajtja e rendit ushtarak në FA, me synim forcimin e disiplinës ushtarake në FA. Në dhjetor të vitit 1994, me Urdhër nr. 482, datë 10.12.1994 të MM, "Për organizimin e Policisë Ushtarake"...

» faqe 5



Miratohet fondi prej 200 milionë lekësh për emergjencat civile



Peleshi: Jetësohet dhe financimi 30 milionë euro nga qeveria italiane

»

Ekipi i Akademisë Ushtarake "West Point", vizitë në AFA

Një ekip nga Akademia Ushtarake "West Point", SHBA, zhvilloi një vizitë pune në Akademinë e Forcave të Armatosura. Në kuadër të masave për transformimin e Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA), sipas modelit të Akademisë Amerikane "West Point" dhe programit të partneritetit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, një ekip nga Akademia Ushtarake e Akademisë "West Point", SHBA, zhvilloi një vizitë pune në Akademinë e Forcave të Armatosura. Qëllimi i vizitës ishte vijimi i punës për përgatitjen e programeve mësimore dhe kurrikulave...



»
Faqe 2

Faruk Kalleshi, legjenda e peshëngritjes shqiptare, në historinë e lavdishme të 21 titujve kombëtarë

Njeriu me shtatin e vogël, por me fuqinë e një gjiganti me një sërë titujsh dhe medaljesh, Faruk Kalleshi, "Nderi i Sportit Shqiptar", marrë në vitin 1999; "Mjeshtër i Madh i Punës" (dhënë nga Presidenti i Republikës Rexhep Mejdani në vitin 2000); fitues disa herë i anketës "10 sportistët më të mirë"; me Urdhër "Nderi i Kombit", dhënë nga Presidenti Bamir Topi në vitin 2012, vjen në një rrëfim të historisë të tij për lexuesin e shtypit ushtarak dhe jo vetëm, si një prej përfaqësuesve të fanellës së Partizanit me mbi 38 rekorde...



»
Faqe 6-7

"Dora që ndihmon është më e shenjtë se goja që lutet"

Varfëria nuk është zgjedhje është fakt që jetohej duke u përshtatur dhimbshëm. Shekulli XXI, "koha e konsumit" Në të vërtetë në botë, për shkak të zhvillimit të teknologjisë, nuk ka pasur asnjëherë kaq sasi dhe shumëllojshmëri ushqimesh për t'u konsumuar nga njerëzit, prandaj edhe koha ku jetojmë quhet "koha e konsumit". Por përsëri në glob ekziston ende varfëria, e cila i mban në kthetrat e saj një kategori dhe grup njerëzish, të cilët jetojnë me minimumin jetik, ose rrezikojnë të vdesin nga etja dhe uria. Varfëria si plagë sociale, vjen nga...



»
Faqe 12

Ekipi i Akademisë Ushtarake "West Point", vizitë në AFA

Një ekip nga Akademia Ushtarake "West Point", SHBA, zhvilloi një vizitë pune në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Në kuadër të masave për transformimin e Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA), sipas modelit të Akademisë Amerikane "West Point" dhe programit të partneritetit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, një ekip nga Akademia Ushtarake e Akademisë "West Point", SHBA, zhvilloi një vizitë pune në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Qëllimi i vizitës ishte vijimi i punës për përgatitjen e programeve mësimore dhe kurrikulave për programet e studimit "Marrëdhënie Ndërkombëtare në Fushën e Mbrojtjes" dhe "Shkenca Komunikimi në Fushën e Mbrojtjes" që janë të planifikuara për t'u hapur gjatë vitit akademik 2023-2024.

Në përfundim të vizitës u rishikuan dhe u përgatitën kurrikulat mësimore për programet "Marrëdhënie Ndërkombëtare në Fushën e Mbrojtjes" dhe "Shkenca Komunikimi Fushën e Mbrojtjes". Të dyja programet u kompletuan me Sullabus-et respektive. Një vëmendje të veçantë mori përgatitja e programit të karakterit.

Krijimi i karakterit për programet e studimit për vitin akademik


2023-2024 do të jetë një nga katër shtyllat kryesore që do të shërbejnë për përgatitjen e drejtuesve të ardhshëm të gatshëm të shërbejnë me nder, të udhëheqin me nder dhe të demonstrojnë performancë të shkëlqyer.

Puna dhe bashkëpunimi me akademinë "West Point" do të vijojë edhe në ditët në vijim deri në përgatitjen e plotë të programeve dhe akreditimin e tyre.



Roli i snajperëve, si një nga armët me vdekjeprurëse në fushën e luftimit, ngelet i pazëvendësueshëm.

Personeli i batalionit të Dytë të Këmbësorisë (b2k), nën drejtimin e instruktorëve amerikanë të SFAB, zhvilluan këto ditë të ftohta dimri, një trajnim të avancuar dhe qitje me këtë lloj arme, në kushtet e temperaturave të ulëta me qëllim rritjen e mëtejshme profesionale.



MIRATOHET FONDI PREJ 200 MILIONË LKËSH PËR EMERGJENCAT CIVILE

Peleshi: Jetësohet edhe financimi 30 milionë euro nga qeveria italiane

Qeveria ka miratuar fondin prej 200 milionë lekësh për emergjencat civile. Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi tha se Ministria e Mbrojtjes alokon fondin brenda 2 ditësh pas kërkesës së kryetarëve të Bashkive, pas evidentimit të një problematike emergjente apo shterimit të mundësive të tyre për ndërhyrje.

Ai tha se do të përdorej një fond shtesë prej 200 milionë lekësh për emergjencat civile. Ndërsa shtoi se qeveria italiane do të bëjë një financim prej 30 milionë eurosh për emergjencat civile në Shqipëri. Në çdo rast që bashkitë do të përballen me situata të krijuara nga Emergjencat Civile, brenda dy ditësh ata mund të marrin fondin e nevojshëm për të mbuluar shpenzimet e paparashikuara në buxhetet e tyre. Fondi është detajuar në mbledhjen e qeverisë më 1 shkurt 2023.

“Përmes Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile e alokon në mënyrë të përshpejtuar brenda dy ditëve pas kërkesës së kryetarëve të bashkive sa herë që evidentohet një problematikë emergjente”, - tha ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi.

“Sot miratuam projektvendimin e propozuar nga Ministria e mbrojtjes, që ka të bëjë me masat në mbështetje të sistemit të emergjencave civile, bëhet fjalë për detajimin e një fondi prej 200 milionë lekësh, ose 2 milionë USD, pjesë e paketës prej 20 milionë USD që buxheti i këtij viti ka alokuar për emergjencat civile. 10 milionë USD janë shpallur kërkesat për projekte për aplikime nga të gjitha bashkitë. Projektet fituese për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore financohen nga ky fond në mënyrë të decentralizuar që do të thotë, ne e alokojmë pjesën fituese të këtij fondi te



bashkitë përkatëse dhe më pas bashkitë bëjnë implementimin e tyre. Pjesa tjetër e fondit prej 800 milionë lekë është transferuar direkte në buxhetet e bashkive e kushtëzuar për investime apo adresuar për çështje të emergjencave civile. Fondi i tretë është ky që po detajohet sot prej 200 milionë lekësh, një

fond që Ministria e Mbrojtjes, përmes Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile e alokon në mënyrë të përshpejtuar brenda 2 ditësh pas kërkesës së krye bashkiakëve sa herë evidentohet një problematikë emergjente dhe bashkisë i shterohen mundësitë e ndërhyrjes dhe ne e kompensojmë përmes këtij

fondi”, - tha Peleshi, i cili bëri me dije ndër të tjera dhe jetësimin brenda këtij viti të financimit nga qeveria italiane të më shumë se 30 milionë eurove, për mbështetje të bashkive në përballimin e fatkeqësive natyrore.

“Këtë vit do jetësohet financimi nga qeveria italiane prej më shumë se

30 milionë euro, tashmë i miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Ky financim do mbështesë bashkitë dhe gjithë sistemin nga niveli vendor duke u ngjitur drejt nivelit qendror të përballimit të fatkeqësive natyrore, thënë ndryshe të emergjencave civile”, - shtoi Peleshi.





Anijet e Grupit të Dytë të Gatshëm të Anijeve Minaheqëse të NATO-s (Standing NATO Mine Countermeasures Group Two - SNMCMG2) të përbërë nga anija flamurtare e FD turke TCG Yüzbaşı Günör, TCG Enez (FD turke), dhe ITS Numana (FD italiane) zhvilluan një vizitë në portin e Durrësit.

Në ditën e parë të vizitës së tyre, përfaqësues të Shtabit të SNMCMG2 zhvilluan një vizitë zyrtare në Komandën e Forcës Detare në të cilën u pritën nga shefi i Shtabit të Forcës Detare, kapiten i rangut I Arsen Mullaj. Pas vizitës në Forcën Detare, delegacioni i SNMCMG2 zhvilluan vizita kortezie në bashkinë dhe prefekturën Durrës.

Gjithashtu, komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra zhvilloi një vizitë kortezie në bordin e anijes flamurtare. Gjatë këtij takimi admiral Agastra uroi erëra të mbara dhe suksese gjatë zhvillimit të stërvitjes së përbashkët me anijet e Forcës Detare.

Gjatë stërvitjes u përpunuan elementë të ndryshëm stërvitorë sipas manualeve standarde të NATO-s, kalim tranzit në kanale të ngushta, transferim i postës, formacione të ndryshme lundrimi. Gjithashtu u zhvillua stërvitja e përbashkët PASSEX.

Në përfundim të stërvitjes u zhvillua edhe një operacion për kërkimin e minave ose pajisjeve shpërthyes në fund të detit në rajonin e Porto - Romanos, Durrës.



Specialistët e Xhenios në ndihmë të banorëve për shpërthimin e masivit shkëmbor

Specialistët e Batalionit Xhenier të Komandës Mbështetëse finalizuan me sukses operacionin për asgjësimin e një masivi shkëmbor në fshatin Topojan, njësi administrative Mollas, bashkia Cërrik, i cili prej kohësh përbente shqetësim madhor dhe rrezikonte banesat dhe jetën e banorëve të zonës. Për prishjen e masivit shkëmbor u krijuan pengesa xheniere për të ruajtur banesat. Prishja e shkëmbit u realizua me dy faza shpërthimi të kontrolluar me eksploziv. Në këtë operacion sensitiv u angazhuan 10 specialistë xhenierë si dhe dy mjete dhe një agregat.

Pas një studimi, që specialistët xhenierë në bashkëpunim me Drejtorinë e Emergjencave në bashkinë Cërrik i bënë zonës, u morën të gjitha masat dhe u vendos që shkatërrimi i masivit shkëmbor të bëhej me shpërthim të kontrolluar, me qëllim eliminimin e rrezikut që i kanosej 15 familjeve të kësaj zone.



PU, reparti elitë në historikun e tij 31-vjeçar

Policia Ushtarake festoi 31-vjetorin e krijimit të saj. Me këtë rast ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi do të shprehte vlerësimin e tij për këtë repart me kontribut të çmuar të Forcave të Armatosura.

“Përgjatë 31 viteve të historisë së saj, Policia Ushtarake ka treguar se është një nga repartet elitë të Forcave të Armatosura.

Ruajtja e rendit ushtarak, garantimi i zbatimit të ligjit, angazhimi në luftën kundër terrorizmit dhe pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse e humanitare janë misioni kryesor i kësaj njësie.

Mirënjohje gjithë grave dhe burrave që kanë shërbyer dhe ngritur lart emrin e Policisë Ushtarake.”

Policia Ushtarake e Forcave të Armatosura u formua më 1 shkurt 1992.

Pas viteve '90, ashtu si në të gjithë vendin edhe në FA u kryen një sërë reformash. Ndër to: miratimi i akteve ligjore, nënligjore, si dhe ndryshime strukturore, ku pjesë e këtyre ndryshimeve ishte dhe krijimi i PU në përbërje të FA-së. Formimi i kësaj strukture kishte si qëllim forcimin e rregullit dhe të disiplinës në FA dhe u pa si domosdoshmëri për transformimin e ushtrisë sipas standardeve të vendeve të NATO-s.

Me krijimin e PU-së, objekti i punës së saj ishte kontrolli i trafikut ushtarak, ruajtja e rendit ushtarak në FA, me synim forcimin e disiplinës ushtarake në FA. Në dhjetor të vitit 1994, me Urdhër nr. 482, datë 10.12.1994 të MM, “Për organizimin e Policisë Ushtarake”, strukturës së PU iu bashkëngjiti struktura e Policisë Kriminale dhe ajo e Mbrojtjes nga Zjarri. Në fillim të vitit 1995 u transformua në drejtori të PU-së, me drejtor gjeneral brigade Bajram Malaj. Me mbështetje ligjore, nënligjore si dhe me profesionalizëm gjithnjë në rritje, PU u radhit ndër repartet më të mira të FA. Pas ngjarjeve të vitit 1997, drejtori i

Drejtorisë së PU-së ishte kolonel Piro Lutaj. Duhet theksuar se pas ngjarjeve të vitit 1997, PU pati një rritje të jashtëzakonshme mbi bazën e një projekti me Delegacionin Italian të Ekspertëve (DIE). Në këtë kohë për herë të parë, me asistencën e specialistëve italianë u krijua batalioni i PU-së në Tiranë, i cili u kompletua me bazën materiale e logjistike të nevojshme dhe u konceptua sipas modelit të batalioneve të karabinierisë italiane.

Krijimi i batalionit të PU-së në Tiranë, shënon një hop cilësor në veprimtarinë e kësaj strukture moderne dhe nga më cilësoret të kohës, gjë që u duk qartë në ngjarjet e vitit 1998, kur PU jo vetëm që nuk u dëmtua por ajo mori në ruajtje disa nga institucionet kryesore të shtetit si: Radio Televizioni Shqiptar, Telekomin, Prokurorinë e Përgjithshme si dhe disa institucione ndërkombëtare.

Në këtë periudhë, PU ishte një nga institucionet e pakta moderne që ishte ndërtuar deri në atë kohë dhe që ka luajtur një rol të pazëvendësueshëm në rivendosjen e shtetit ligjor në Shqipëri.

Kompletimi i batalionit të PU-së në Tiranë, me tekniken e nevojshme dhe automjete të blinduar tip IVECO-90, luajti një rol të jashtëzakonshëm në ngjarjet e vitit 1998 në Shqipëri. I pamohueshëm mbetet roli i kësaj strukture në vitin 1999, në kohën e krizës së Kosovës, ku PU mbajti peshën kryesore në pritjen, shoqërimin, trajtimin e ref-



ugjatëve pranë kampingjeve të ngritura në Kukës, Tiranë, Durrës dhe qytete të tjera të vendit, mbajtjen nën kontroll të situatës në zonat Kukës, Krumë, Tropojë, sidomos pranë postave kufitare, duke zgjidhur mjaft situata të vështira, shoqërimin e mjaft autokolonave dhe personaliteteve që lëviznin për në veri dhe kthim, si dhe mbajtjen nën kontroll të rrjetit rrugor në të gjithë vendin e veçanërisht në veri. Ngjarjet e vitit 1997, 1998 dhe ato të krizës kosovare janë ngjarjet më të rëndësishme në historinë e PU-së. Për kryerjen e këtyre detyrave, PU u mbështet dhe në miratimin e Ligjit nr. 8404, datë 15.09.1998, për një shtesë në Ligjin nr. 7978, datë 26.07.1995, “Për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Në fund të vitit 2000, me suprimimin e strukturës së Drejtorisë së Policisë Ushtarake, me Urdhër nr. 1, datë 05.01.2001 të MM, “Për organizimin e regjimentit të Policisë Ushtarake”, u krijua regjimenti i PU-së me komandant nënkolonel Namik Goga. Kjo strukturë e ushtrisë aktivitetin e saj deri në shtator të vitit 2003, duke bërë ruajtjen dhe sigurimin e të gjitha stërvitjeve që zhvilloheshin në territorin e vendit tonë.

Në shtator të vitit 2003, kjo strukturë u transformua në strukturën e

batalionit me qendër në Tiranë, me komandant batalioni nënkolonel Xhevahir Abdia, i cili e ushtroi detyrën deri në vitin 2005. Në vitin 2005 komandant batalioni u emërua nënkolonel Drini Nikolla, i cili e ushtroi këtë detyrë deri në vitin 2008.

Në korrik të vitit 2007, batalioni i PU-së ishte pjesë organike e Komandës Mbështetëse, me varësi drejtimi administrativ në Komandën Mbështetëse dhe Komandim Operacional nga SHPPFA. Në përbërje të këtij batalioni ishin 4 seksione të PU-së në rrethet Shkodër, Durrës, Berat, Vlorë dhe 5 nën seksione të PU-së, në rrethet: Kukës, Burrel, Elbasan, Korçë dhe Gjirokastrë. Në vitin 2008, komandanti i batalionit të PU-së emërohet kolonel Xhevdet Zeneli. Në maj të vitit struktura e Policisë Ushtarake kaloi në Policia Ushtarake e Forcave të Armatosura, në përputhje të plotë me Ligjin nr. 9069, datë 15.05.2003, “Për Policinë Ushtarake në FA”.

Në qershor të vitit 2012, komandanti i PU-së emërohet kolonel Syrja Gjoka.

Në gusht të vitit 2012, komandanti i PU-së emërohet kolonel Ylli Zyla.

Në shtator të vitit 2013, komandanti i PU-së emërohet kolonel Xhevdet Zeneli. Veprimtaria e PU-së përcaktohet



nga misioni dhe detyrat që parashikohen në ligjin, “Për Policinë Ushtarake në FARSH” dhe “Kodi Penal Ushtarak”. Hartimi dhe miratimi në Kuvend i këtij ligji në vitin 2003, shënon një ristrukturim të plotë të kësaj strukture.

Gjatë kësaj periudhe është punuar për kompletimin e PU-së me personel të motivuar, arsimuar në vendet anëtare të



NATO-s, si në Turqi, Itali, Gjermani. Realizimi i misionit dhe detyrave funksionale është mbështetur në aktet ligjore e nënligjore.

Gjatë këtyre viteve PU, është trajnuar nga specialistë të karabinierisë italiane, policisë ushtarake amerikane, gjermane dhe turke.

Prej vitesh, njësia e PU-së po përgatit me një program të veçantë një nënrepart të nivelit toge NRF (NATO Response Force), si forcë e gatshme për të vepruar në përbërje të strukturës përkatëse të NATO-s, e aftë dhe e pajisur përshtatshëmish për të përmbushur detyrat.

Gjithashtu, PU ka kryer një mision në operacionin ushtarak “ISAF”, në Kabul, Afganistan. Kontingjenti i kësaj toge përbëhej nga një efektiv prej 22 vetash.

Një kontribut të madh, efektiv i PU-së ka dhënë në emergjencat civile,

ku kanë treguar gatishmëri dhe profesionalizëm në kryerjen e detyrave të marra.

Tashmë, struktura e PU-së është e përgatitur për të vepruar në të gjithë spektrin e misionit, detyrave, si edhe të marrë pjesë në operacione paqeruajtëse dhe humanitare.

- Ruajtja e rendit ushtarak në FARSH, zbulimi, parandalimi, ndjekja e veprimtarisë kriminale, angazhimi në luftën kundër terrorizmit, marrja pjesë në operacionet paqeruajtëse dhe humanitare, si dhe mbrojtja e pronës shtetërore në administrim dhe përdorim të Forcave të Armatosura nga veprimet e kundërligjshme. Siguron rendin ushtarak jashtë reparteve ushtarake në mjediset publike e jopublike.

- Mbron jetën, shëndetin dhe dinjitetin e ushtarikut nga çdo veprim i paligjshëm kur ato cenohen për shkak të detyrës.

- Mbron pronën shtetërore në administrim dhe përdorim të FA-së nga veprimtari të kundërligjshme.

- Ndërhyn për të mënjanuar aktet e terrorizmit në FA.

- Punon për zbulimin, parandalimin dhe ndjekjen e veprimtarisë kriminale ndaj pjesëtarëve të FA-së, pronës dhe objekteve ushtarake.

- Zbaton vendimet e gjykatës, aktet e Prokurorisë Ushtarake për kërkimin, kapjen dhe sjelljen forcërisht të ushta-

rakëve që i fshihen procedimit penal ose i shmangen vuajtjes së dënimit.

- Kontrollon dhe siguron transportin ushtarak.

- Kontrollon lëvizjen dhe shfrytëzimin e mjeteve dhe teknikës ushtarake.

- Kontrollon e merr masa për zbatimin e legjislacionit të Masave të Ndërhyrjes kundra Zjarrit (MNZ).

- Siguron zbatimin e rendit ushtarak gjatë zhvillimit të stërvitjeve, veprimtarisë dhe ceremonive ushtarake të organizuara nga SHPPFA.

- Shoqëron e siguron personalitetet e larta ushtarake të FA-së, si dhe delegacionet e huaja të njehsuara me to.

- Kryen detyra në interes të forcave ushtarake shqiptare që kryejnë misione jashtë shtetit, si dhe të forcave të huaja ushtarake që veprojnë në Shqipëri në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Kryen e mbështet operacionet humanitare.

INTERVISTË ME FARUK KALLESHIN, "NDERI I SPORTIT SHQIPTAR"

INTERVISTOI
ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Faruk Kalleshi, legjenda e peshëngritjes shqiptare, në historinë e lavdishme të 21 titujve kombëtarë

Njeriu me shtatin e vogël, por me fuqinë e një gjiganti me një sërë titujsh dhe medaljesh, Faruk Kalleshi, "Nderi i Sportit Shqiptar", marrë në vitin 1999; "Mjeshtër i Madh i Punës" (dhënë nga Presidenti i Republikës Rexhep Mejdani në vitin 2000); fitues disa herë i anketës "10 sportistët më të mirë"; me Urdhrin "Nderi i Kombit", dhënë nga Presidenti Bamir Topi në vitin 2012, vjen në një rrëfim të historisë të tij për lexuesin e shtypit ushtarak dhe jo vetëm, si një prej përfaqësuesve të fanellës së Partizanit me mbi 38 rekorde kombëtare.

Faruk Kalleshi e mbylli karrierën me 3 medalje ari në Spartakiadën e vitit 1984.

Më 1966 fiton anketën "5 sportistët më të mirë të vitit", si pjesë e Partizanit.

21 vite kampion radhazi, nga viti 1964 deri në fund të vitit 1984.

Karrierën si trajner e nisi në vitin 1972 në Shkodër. I bënte të dyja njëherësh, edhe sportist edhe trajner. Po në Shkodër, ka punuar inspektor i sporteve të rënda. Ka punuar për shumë kohë mësues i edukimit fizik në Shkollën e Mesme Pyjore, Shkodër.

Trajner i Kombëtares së shtangës në vitet 2004-2007, kohë edhe kur e mbylli përfundimisht angazhimin e tij me peshëngritjen. Karriera sportive e Faruk Kalleshit është e mbushur me medalje e rekorde, si sportist e si trajner.

Unikal për kohën e vijon të jetë i tillë, pasi ka forcë të pashtershme. Rezultatet e tij të larta, kohështrirja e karrierës dhe natyrisht karakteri i tij tërheqës, e kanë bërë të cilësohet më pompozitet si një sportist kampion i padiskutuar, rekordmen i klasit të parë.

Si lindi dëshira për t'u marrë me peshëngritjen?


Unë kam filluar në cirk, në estradën profesioniste të Shkodrës bashkë me Liljanën, dashurinë e jetës time, në atë sallë ku bënim stërvitjen, bëheshin edhe sportet e tjera, peshëngritja dhe mundja.

Unë, si i ri, nga kurioziteti afrohesha shpesh dhe i kundroja me admirim, dhe shpesh pyesja: si e çojnë gjithë këtë peshë? Dhe fillova të provoja dhe vetë. Trajneri i asaj kohe Njazi Bushati, duke parë konstruktin e bukur fizik dhe forcën e madhe, më sugjeroi të afrohesha tek ky sport dhe me thënë të drejtën nuk e kisha me shumë qejf. Por me ndikimin e babait tim, i cili kishte qenë kampion peshëngritje në vitin 1951, fillova të stërvitem dhe shkoj në garën e parë ku ishin 12 konkurrentë, nuk i njihja, ishte e para herë edhe që dilja. Kujtoj momentin e parë kur më thërrasin emrin për me dalë te pedana, emocionet ishin, si hera e parë.

E ngre shtangën me herën e parë, duartrokite të stuhishme; te prova e dytë unë thyej rekord.

Në atë garë unë theva katër rekorde kombëtare dhe shpërblimi jepej për çdo rekord.

Vitin tjetër i bëja të dyja, gjeja kohë



FARUK KALLESHI
"Nderi i Kombit"

për peshëngritjen për të përvetësuar më shumë teknikën, bëja edhe akrobacinë dhe mosha e re i përballonte dhe nuk më dukej ndonjë gjë kushedi. Që në garat e para, në vitin 1965, unë kam thyer shumë rekorde, gjatë atij viti kam thyer 20 rekorde.

Interesantja është se aty në fund të vitit, isha ai sportisti primar, nëpër ato anketat "5 sportistët e vitit". Votohej kush ishim pesë sportistët më të mirë të vitit, emri im ishte gjithnjë tek pesë më të mirët. Në fund të vitit më kërkoni të shkoja ushtar.

Ligjërisht nuk duhej të shkoja se kisha një vëlla marinar, nuk duhej të ishin dy nga një familje. Dhe sa kam shkuar ushtar, jam shpallur fitues i anketës "5 sportistët më të mirë të vitit", kuptohet bëri jehonë shumë.

Sa kohë i duhet një shtangisti të luftojë për medalje?

Sporti dhe përgatitja në tërësi e një sportisti për veprimtaritë ndërkombëtare nuk ka pushim. Që të bëhesh kampion i madh duhet punë gjithëvjetore, sistematike. Sigurisht, ka dhe faza

brenda saj që janë intensive. Përgatitjet me fushata krijojnë trauma dhe dëmtime afatgjata. Sot kushtet janë që të mos ketë marrëzira të këtij lloji. Ecurinë e ndjekin trajnerët, por që të realizojnë objektivat e tyre duhet të stimulohen financiarisht, e pastaj t'u kërkohet llogari.

Sa orë stërvitje bënit në ditë?

Të them të drejtën katër apo pesë orë në ditë, më ka pas shkuar. Orari, orar, pushimi, pushim. Ushqimi, ushqim. Madje, edhe kur e kam lënë

“

NJERIU ME SHTATIN E VOGËL, POR ME FUQINË E NJË GJIGANTI ME NJË SËRË TITUJSH DHE MEDALJESH, FARUK KALLESHI, "NDERI I SPORTIT SHQIPTAR", MARRË NË VITIN 1999; "MJESHTËR I MADH I PUNËS" (DHËNË NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS REXHEP MEJDANI NË VITIN 2000); FITUES DISA HERË I ANKETËS "10 SPORTISTËT MË TË MIRË"; ME URDRHIN "NDERI I KOMBIT", DHËNË NGA PRESIDENTI BAMIR TOPI NË VITIN 2012, VJEN NË NJË RRËFIM TË HISTORISË TË TIJ PËR LEXUESIN E SHTYPIT USHTARAK DHE JO VETËM, SI NJË PREJ PËRFAQËSUESVE TË FANELLËS SË PARTIZANIT ME MBI 38 REKORDE KOMBËTARE.

krejt sportin, kam vazhduar të jem strikt me ushqimin.


Edhe në atë kohë kam qenë jashtëzakonisht i saktë. Kam qenë shumë preciz.

Kush ka qenë gara që ka lënë mbresë në karrierën e Faruk Kalleshit?

Në karrierën time ka pasur shumë episode të bukura, një nga ato që mbeten në histori dhe kujtohen për emocionet e jashtëzakonshme, ishte ajo e organizuar në Turqi, pikërisht në Ankara, në vitin 1981, në kuadër të turneut të 100-vjetorit të Atatürkut. Midis shumë shteteve pjesëmarrëse, ia dola që të fitoj medaljen e artë për peshën time.

Në pallatin e sportit të Ankarasë kishte shumë shqiptarë, të cilët u ndjenë vërtet krenarë, u trondit pallati i sportit nga ovacionet e shumta dhe entuziazmi që mbërtheu të pranishmit.

Në momentin kur u dorëzua medalja dhe u këndua himni kombëtar, më shpëtuan lotët. Aty kam ndjerë kënaqësinë më të madhe të arritjeve të mia. Atë vit unë fitova anketën e 6-të "10 sportistët më të mirë të vitit". Ishin emocione të rralla për kohën, të cilat i kujton me nostalgji. Fundja këto arritje nuk ishin vetëm të sportistit, por të sportit shqiptar në tërësi.



Cilët emra i mbanin këto rekorde para jush?

Një emër i madh është Besim Pula, që ka qenë në lojërat e Ganefos. Atje

kam njohur emra që vinin kryesisht nga akrobacia, Telat Agollin, Hamdi Petrelën, Bujar Bodinakun, d.m.th ata bënë edhe cirkun edhe shtangën.

Kur ka qenë dalja juaj e parë jashtë Shqipërisë?

Për herë të parë unë kam dalë në vitin 1966, në Kinë, aty ishin



lojërat e ‘Ganefos’. Mua në këtë kohë më kishin ikur emocionet e fillimit dhe kam qenë shumë agresiv në garë. Kam pasur një ego të jashtëzakonshme.

Kush më ka njohur, nëse Faruku ka çuar një kile në stërvitje, në garë ka çuar një kile e gjysmë.

Këto më kanë ndodh edhe tek cirku, edhe te peshëngritja; nuk kam pasur regres, por vetëm progres. Kam vetëm një moment që kam pasur regres, që është i vetmi, që edhe ai është një diçka shumë e veçantë.

Në Kinë, pallati ku po bënim garën e parë quhej “Pallati Punëtori”, Pekin, kishte 20 mijë spektatorë. Mbaj mend që ka qenë edhe i madhi Loro Boriçi, trajneri i Kinës, kishte shkuar të ndihmonte Kinën. Ishte trajner. Ai si shkodran më kishte njohur mua te Partizani si sportist dhe ma kishte vendosur epitetin ‘Harushë’. Nga tribuna, më thotë nga larg ‘Harushë’, a po e thyen rekordin?” Dhe unë që i përgjigjem me kokë; Po nuk diskutohej, e ngrita shtangën dhe kap një, dy rekorde.

Më thoshte, ty të ka dhënë Zoti me të dashtë gjithkush, edhe armikun e kënaq në garë se ke rezultate shumë të mëdha. Vetë harku kohor i gjatë, d.m.th nga dita e parë kampion dhe me mbylljen si kampion, jam ndër të vetmit.

A ka ndonjë peshëngritës tjetër që ka thyer më shumë rekorde se ju?

ndikimi pati bashkëshortja juaj në karrierën tuaj të mbushur me suksese e rekorde?

Në moshë mjaft të re, njoha një vajzë, Liljana Pacin, shumë e talentuar, me virtyte të jashtëzakonshme, ajo ishte talent i rrallë. Më vonë, krahas simpatisë së akrobate, më lindi simpatia si njeri. Ndoshta se isha në kulmin tim,



ku tentova të thyeja rekordin botëror, në vitin 1970, vendosa të bëj një lidhje serioze, të cilën e finalizuam në nëntor të vitit 1970 me martesën tonë. Nëse

Liljana Kalleshi



“Laurat i Republikës”

Në Festivale Kombëtare të Estradave Profesioniste, marrë Çmime të Para

Medalje “Naim Frashëri”

Titulli “Preng Jakova” nga Bashkia Shkodër

Urdhëri “Naim Frashëri i Artë”

Titulli “Mjeshtër i Madh”

“Nderi i Qarkut Shkodër

“Qytetare Nderi Tropojë”

Artiste Profesioniste “Teatri Migjeni”

Titulli “Kalores i Urdhërit të Flamurit

Jo, nuk ka. Unë jam më jetëgjati në anketat e dhjetë sportistëve më të mirë. Sot nuk krahasohet koha e sotme me të kaluarën.

Sa vjet të zgjati karriera?

21 vjet pa ndërprerje. Për shumë kohë punova me ekipin privat “Juvenilja”. Ekip femrash, ku ishin edhe Romela Begaj dhe Fetije Kasaj.

Faruk Kalleshi është një emër që nuk e ndan dot nga “gjysma e tij”, për të cilën ai flet me dashurinë e bashkëshortit, vlerësimin e kolegut dhe respektin e nënës së fëmijëve të tij.

Si lindi kjo dashuri dhe çfarë

unë kam pasur arritje të mëdha, krahas aftësisë dhe talentit tim, vlera kryesore e arritjeve të mia i përket Lilit. Sepse, krahas anës morale, edhe në aspektin familjar nuk kisha preokupime se ajo i përballoi vetë. Prandaj, e shpreh me sinjeritet se arritjet e mia janë njëkohësisht edhe kontribut i saj.

Znj. Liljana është ish-sportiste, akrobate e njohur profesioniste, laureatë e çmimit të Republikës, çmimi më i lartë i asaj kohe.

Familja Kalleshi ka dy fëmijë, të cilët gëzojnë respektin dhe reputacionin e tyre falë përkushtimit të dy prindërve me një karrierë brilante por dhe me “prindërim” të suksesshëm.

Spinoff-et e NASA-s forcojnë qëndrueshmërinë ndaj klimës, përmirësojnë kujdesin mjekësor

Kur bëhet fjalë për NASA-n, shumica e njerëzve shikojnë qiellin ndërsa raketat, roverët dhe astronautët i shtynë kufijtë e eksplorimit të hapësirës. Por përfitimet e të shkuarës mbi dhe përtej mund të gjenden këtu në Tokë, përmes produkteve dhe shërbimeve të lindura nga inovacioni i NASA-s.

Edicioni i fundit i botimit "Spinoff" të NASA-s përmban dhjetëra teknologji të reja të komercializuara që përdorin teknologjinë, kërkimin dhe/ose ekspertizën e agjencisë për të përfituar njerëzit anëmbanë globit. Ai gjithashtu përfshin një seksion që thekson teknologjitë e së nesërme.

Publikimi "Spinoff 2023" i NASA-s përmban më shumë se 40 kompani që përdorin risitë e NASA-s për të përfituar njerëzit anëmbanë globit.

"Nga qiejt në spitalet anëmbanë botës, spinoffet e NASA-s po përmirësojnë jetën për të gjithë njerëzimin," - tha administratori i NASA-s Bill Nelson. "Puna që NASA bën në kërkime dhe teknologji u jep bizneseve një avantazh konkurrues, duke nxitur një ekonomi që i lejon Amerikës të konkurrojë globalisht dhe të krijojë vende pune me pagesë të mirë për këtë brez - dhe për brezin e ardhshëm."

"Spinoff 2023" i NASA-s përmban më shumë se 40 kompani që përdorin teknologjinë, kërkimin dhe financimin e NASA-s për të krijuar bateri më të mira për të ruajtur energjinë e gjelbër, për të përmirësuar trafikun tokësor të aeroportit për të kursyer kohë pasagjerëve dhe linjave ajrore duke ulur kostot e karburantit, për të shpërndarë ventilatorë në mbarë botën dhe madje për të shëruar plagët më shpejt si të njerëzit ashtu edhe të kafshët.

"Përpara se të nisej dhe të na jepte një pamje të re të universit, teleskopi hapësinor "James Webb" i NASA-s tashmë po përmirësonte një nga operacionet më të zakonshme të syve në Tokë", - tha Jim Reuter, administrator i asociuar i Drejtorisë së Misionit të Teknologjisë Hapësinore të Agjencisë (STMD). "Ky është vetëm një shembull se si teknologjia që ne zhvillojmë për eksplorimin e hapësirës po përmirëson cilësinë e jetës për njerëzit këtu në Tokë."

Një mjet i ri për diagnostikimin e kancerit i informuar nga kërkimet mbi astronautët e ekspozuar ndaj rrezatimit hapësinor gjatë qëndrimit në Stacionin Ndërkombëtar të Hapësirës, është një teknologji e projektuar nga NASA që ndihmon në gjetjen e njerëzve të bllokuar në prag të fatkeqësisë dhe një program i ri modeli i printimit 3D që përdor "klonimin dixhital", për të ulur kostot dhe për të përsheptuar zhvillimin e pjesëve komplekse industriale.

"Nuk është vetëm industria komerciale e hapësirës që mund të shfrytëzojë risitë tona", - tha Daniel Lockney, ekzekutiv i programit të Transferimit të Teknologjisë të NASA-s. "Praktikisht çdo zonë industriale mund të gjejë një teknologji të NASA-s si një zgjidhje për nevojat e saj të biznesit. Shkencëtarët, studiuesit dhe inxhinierët tanë po krijojnë vazhdimisht materiale, softuer, mjete dhe më shumë. Nëse nuk është këtu tani, së shpejti do të jetë."

Spinoff është pjesë e programit të Transferimit të Teknologjisë të Agjencisë brenda STMD. Programi është i ngarkuar me gjetjen e aplikacioneve më të gjera të mundshme për teknologjinë NASA përmes partneriteteve dhe marrëveshjeve të licencimit me industrinë, duke siguruar që investimet e NASA-s në misionet dhe kërkimin e saj të gjejnë aplikacione shtesë që përfitojnë kombin dhe botën.



"Multi Radiance Medical of Solon", Ohio, ndërton pajisje të terapisë me dritë të bazuar pjesërisht në kërkimet e financuara nga NASA. Linja e pajisjeve të terapisë me dritë të Multi Radiance Medical, që kombinon dritën LED dhe lazer super-pulsues, përfshin produkte të krijuara posaçërisht për përdorim të kafshët.

NASA do të financojë një raketë bërthamore për të çuar njerëzit në Mars në vetëm 45 ditë

NASA ka zbuluar fondet për një raketë me energji bërthamore që mund të shkurtojë kohën e udhëtimit në Mars nga shtatë muaj në vetëm 45 ditë.

Raketa Bimodal Bërthamore Termike mund të përdoret për të transportuar si njerëz ashtu edhe mallra nëpër Sistemin Diellor, duke reduktuar ndjeshëm rrezikun kryesor që lidhen me udhëtimin ndërplanetar, siç është ekspozimi ndaj rrezatimit.

Koncepti u parashtrua nga profesori Ryan Gosse nga Universiteti i Floridës, i cili pretendoi se dizajni bimodal do të "revolucionarizonte eksplorimin e thellë të hapësirës".

Nasa do të ndihmojë në financimin e zhvillimit të raketës përmes një sërë grantesh të reja që synojnë financimin e "projekteve me rrezik të lartë dhe me shpërblim të lartë që kanë potencialin për të "përmirësuar në mënyrë drastike" misionet hapësinore gjatë dekadave të ardhshme.

"Duke punuar së bashku, në të gjithë qeverinë dhe me industrinë, Shtetet e Bashkuara po avancojnë shtytjen bërthamore në hapësirë", - tha Jim Reuter, administrator i asociuar për Drejtorinë e Misionit të Teknologjisë Hapësinore të NASA-s.

"Këto kontrata projektimi janë një hap i rëndësishëm drejt pajisjeve të prekshme të reaktorit që një ditë mund të nxisë misione të reja dhe zbulime emocionuese".

Nga vitet 1950 deri në vitet 1980, programet hapësinore amerikane dhe sovjetike eksploruan mundësinë e përdorimit të shtytjes bërthamore-termale (NTP) për udhëtime në hapësirë. Ai përfshin ngrohjen e shtytës të lëngshëm të hidrogjenit në një reaktor bërthamor, i cili e kthen atë në plazmë që gjeneron shtytje.

Në vitet 2000, NASA u përpoq të zhvillonte një lloj të ri raketë duke përdorur shtytje bërthamore-elektrike (NEP), e cila përdor një reaktor bërthamor për të gjeneruar energji elektrike për një motor të aftë për të prodhuar një fushë elektromagnetike për të jonizuar gazin për ta përdorur si shtytje. Duke kombinuar të dyja teknologjitë NTP dhe NEP përmes një metode shtytjeje bimodale, dizajni i profesor Gosse teorikisht do të dyfishonte shpejtësinë që secila teknologji do të ishte në gjendje të prodhonte vetë.



Raketa bërthamore e NASA Mars, jpeg © NASA

"Rafael" zbulon raketën e gjeneratës së 6-të Spike NLOS

Familja e raketave SPIKE të "Rafael"-it, të raketave drejtuara elektrooptike shumëfunktionale, siguron saktësi të me precizion në rreze të gjata me variantin NLOS që angazhon me sukses objektivat të distancave të mëdha. SPIKE NLOS, i lëshuar nga platformat ajrore, tokësore ose detare, ofron inteligjencë kritike taktike dhe vlerësime të dëmtimit në kohë reale, duke e lejuar atë të rregullojë objektivat dhe të ndërpresë misionet në mes të fluturimit dhe të operojë si në skenarë sulmi ashtu edhe të mbrojtjes.

Gjenerata e 6-të SPIKE NLOS, e bazuar në suksesin e jashtëzakonshëm operacional të të gjithë familjes së raketave SPIKE, përfshin disa aftësi të reja, të zgjeruara për të llogaritur nevojat dhe tendencat moderne të fushëbetjës. Në mënyrë të veçantë, këto teknologji të avancuara mbyllin më shpejt qarkun sensor-qitës dhe neutralizojnë në mënyrë më efikase sulmet e tufës nga zonat e ndalimit, duke përmirësuar si rezultat mbijetesën e përgjithshme të fushëbetjës.

Disa nga këta elementë më të rinj të gjeneratës së 6-të SPIKE NLOS përfshijnë:

Aftësitë e lëshimit dhe kontrollit të Salvos: Nga një lëshues dhe operator i vetëm, gjenerata e 6-të SPIKE NLOS mund të lëshojë dhe kontrollojë salvo ajrore deri në katër raketa njëkohësisht. Kjo aftësi e re mundëson operacionalizimin e elementit të befasisë dhe krijon një efekt të menjëhershëm, domethënë.

Dorëzimi i sistemit dhe transferimi i kontrollit: Kontrolli mbi raketat e lëshuara të gjeneratës së 6-të NLOS mund të transferohet midis platformave të fushëbetjës në mes të fluturimit për sukses optimal në të gjithë skenarët operacional. Për shembull, nëse një helikopter lëshon raketën kundër një objekti me vlerë të lartë, por vazhdon të fluturojë jashtë zonës së kërcënuar, një mjet tokësor në atë



Foto: Rafael

zonë ose afër zonës së sulmit mund të marrë kontrollin e raketës së lëshuar dhe ta lundrojë atë drejt objektivit origjinal. Ky transferim i kontrollit mundëson një bashkëpunim të pandërprerë midis sistemeve dhe një ritëm të pandërprerë operacional.

Përvetësimi i imazhit të synuar: Aftësitë e reja të përputhjes së imazhit të RAFAEL janë integruar në gjeneratën e 6-të të NLOS për të mundësuar transferime të shpejta të imazheve ajrore në sistemin e raketave. Mbyllja efektive dhe e saktë e sensorit-qitës është një nevojë kritike operationale e cila më parë kryhej përmes koordinatave të transferuara të objektivit. Tani, imazhet e objektivit mund të përputhen me imazhet video të raketës gjatë fluturimit, duke caktuar një objektivi për operatorin e duhur. Për herë të parë, fokusi është vetë objektivi, në vend të koordinatave apo vendndodhjes së tij, duke mundësuar një sulm edhe më të saktë. Kjo aftësi është veçanërisht e dobishme kur kemi të bëjmë me disa objektiva ose objekte të ngjashme. Për shembull, nëse një numër tankesh të armikut identifikohen në afërsi, aftësia "Target Image Acquisition" (marrja e imazhit të objektit) lejon NLOS-in të bëjë dallimin midis automjeteve dhe të identifikojë tankun e komandantit, ose mjetin më të rëndësishëm armiqësor dhe ta godasë atë drejtpërdrejt. Kjo mundëson minimizimin e dëmit kolateral dhe efektivitet më të lartë veçanërisht në mjedis urbanë më të dendura.

Gama e zgjeruar e raketave: NLOS gjenerata e 6-të tani arrin rreze të zgjeruara deri në 50 km kur lëshohet nga një helikopter dhe deri në 32 km nga platformat tokësore dhe detare. Së bashku me lëshimin jashtë vijës së shikimit dhe aftësitë pasive të NLOS, ky diapazon i zgjeruar rrit mbijetesën tashmë shumë të lartë të platformës. Për më tepër, duke mos kompromentuar saktësinë, efikasitetin ose vdekjen, gjenerata e 6-të NLOS është zgjidhja optimale për tejkalimin e objektivave kundër aksesit dhe mohimit të zonës (A2/AD) mbi përdorimet e tij tradicionale.

Ran Gozali, Shef i Divizionit Tokësor dhe Detar: "SPIKE NLOS shërben si themeli i të gjithë familjes së raketave SPIKE e cila ka arritur sukses të jashtëzakonshëm dhe është përfshirë gjerësisht gjatë viteve, duke u operuar nga tridhjetë e nëntë klientë në mbarë botën. NLOS ka evoluar dhe tani ne shohim modelin e tij më të avancuar dhe më të aftë, gjeneratën e tij të 6-të. Për RAFAEL, ai është një burim krenarie e madhe dhe emblematike e krijimtarisë dhe inovacionit të tij. Kjo raketë e avancuar NLOS tregon mirëkuptimin tonë për nevojat operationale të klientëve tanë dhe ofron përgjigjen më të mirë të mundshme."

“Dora që ndihmon është më e shenjta se goja që lutet”



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Varfëria nuk është zgjedhje është fakt që jetohe duke u përshtatur dhimbshëm.

Shekulli XXI, “koha e konsumit”


Në të vërtetë në botë, për shkak të zhvillimit të teknologjisë, nuk ka pasur asnjëherë kaq sasi dhe shumëllojshmëri ushqimesh për t’u konsumuar nga njerëzit, prandaj edhe koha ku jetojmë quhet “koha e konsumit”. Por përsëri në glob ekziston ende varfëria, e cila i mban në kthetrat e saj një kategori dhe grup njerëzish, të cilët jetojnë me minimumin jetik, ose rrezikojnë të vdesin nga etja dhe uria. Varfëria si plagë sociale, vjen nga shumë shkaqe, shkaktuar kryesisht nga katastrofat natyrore, pamjaftueshmëria e burimeve ushqimore, largimi nga zonat rurale (fshatrat), mbipopullimi i zonave urbane (qyteteve), ekspansioni ekonomik i shteteve të pasura ndaj atyre të varfra, nga keq menaxhimi i qeverive përkatëse, padrejtësia, papunësia, nga luftërat etj.

Më shumë se 1 miliard njerëz shtrihen për të fjetur çdo natë të uritur

Varfëria është një nga format e terrorizmit të sotëm global, varfëria e imponuar, depersonalizon viktimat e saj, të cilët të shtrënguar nga krizat e urisë përfundojnë deri aty sa kërkojnë për “ushqim” mbeturinat që klasifikohen si plehra në kazanë dhe landfillet, duke ulur dinjitetin njerëzor, si në atë të kafshëve, që presin thërrimet që bien nga tryeza e zotërinjve. Kjo gjendje sociale çnjerëzore i detyron njerëzit të bëjnë punë të zeza të ulëta, të pista të pamoralshme, vetëm për një copë bukë. Situata bëhet më tragjike kur urinë e vuajnë dhe fëmijët që lindin nga prindër të varfër në vende të varfra dhe për shkak të keqshqyerjes, urisë dhe etjes bëhen viktima të vdekjes, ende pa shijuar rrezet e para të diellit. Sipas statistikave: uria shkakton vdekjen e 2.6 milionë fëmijëve në mbarë rruzullin tokësor çdo vit dhe çdo 3 sekonda një fëmijë vdes si pasojë e urisë.

Nga statistikave globale edhe vendi ynë, i cili ka nivelin më të ulët ekonomik në rajon nuk i shmanget dot varfërisë dhe urisë. Të gjithë këta të varfër nuk janë viktima thjesht të fatit, sepse fati ekziston në subkoshiençën njerëzore, por në përgjithësi janë viktimat e indiferencës shoqërore dhe më keq të egoizmit dhe lakmisë së njerëzve të pangopur të cilët shohin ‘unin’ e tyre, për më tepër marrin dhe atë që u takon të tjerëve.

Këta të varfër të injoruar, të keqpërdorur nga shoqëria konsumiste egoiste, i kemi kudo.



Ka nga ata të varfër që nuk duan të jetojnë me moral dhe dinjitet njerëzor: “Mos vidh, mos gënje, mos vrit, mos lakmo, puno ndershëm”. Këta njerëz janë të varfër jo nga padrejtësia e të tjerëve, por për shkak të padrejtësisë ndaj vetes, të përtacisë, paudhësisë, abuzimit, krimit dhe mbi të gjitha të pabesisë.

Varfëria, problem social

Kudo në botë, turpi që ndiejnë ata që përballen me vështirësitë ekonomike mund të shndërrohet në një kurth. Vetëm kur politikë bërësit të kuptojnë se dinjiteti dhe respekti për veten janë parakushte kundër privimit, atëherë bota do të ketë një mundësi për ta çrrënjësuar varfërinë në të gjitha format e saj.

Të jesh i varfër është një përvojë

që nëse nuk e provon thjesht ndien mëshirë, një përvojë që degradon dinjitetin dhe ndjenjën e vetëvlerësimit tek tjetri. Ndërkohë që manifestimet dhe shkaqet e varfërisë ndryshojnë, poshtërimi që e shoqëron atë është universal. Megjithatë, pavarësisht provave të qarta që e lidhin varfërinë me shqetësimin psikologjik, politikat që luftojnë varfërinë zakonisht nuk e marrin parasysh turpin. Përkundrazi, përpjekjet për uljen e varfërisë kanë tendencë të përqendrohen te manifestimet e prekshme të privimit, siç janë mungesa e të ardhurave ose e arsimimit.

Ndjenja e ç’nderimit që shoqëron varfërinë dhe i pengon njerëzit të ndër-marrin masa pozitive për të përmirësuar situatën e tyre, është parë kudo në botë.

Në Indi, turpi që lidhet me humbjet e drithërave dhe stresi financiar i kanë shtyrë fermerët drejt abuzimit me substanca dhe në raste ekstreme edhe drejt vetëvrasjes, nxënësit e varfër të shkollave të mesme thonë se pamundësia për të paguar tarifat, për të blerë uniformat apo për të marrë gjërat shkollore është një burim i vazhdueshëm poshtërimi.

Për të trajtuar turpin nga varfëria dhe për të llogaritur në mënyrë adekuate rolin që luan turpi në vazhdimin e varfërisë, duhet të ndërmerren disa hapa.

Për fillestarët, politikë bërësit duhet ta njohin problemin. Në vend që ta shohin turpin si një nënprodukt fatkeq të të jetuarit në varfëri, planifikuesit e zhvillimit njerëzor duhet të marrin



VARFËRIA ËSHTË NJË NGA FORMAT E TERRORIZMIT TË SOTËM GLOBAL, VARFËRIA E IMPONUAR, DEPERSONALIZON VIKTIMAT E SAJ, TË CILËT TË SHTRËNGUAR NGA KRIZAT E URISË PËRFUNDOJNË DERI ATY SA KËRKOJNË PËR “USHQIM” MBETURINAT QË KLASIFIKOHEN SI PLEHRA NË KAZANË DHE LANDFILLET, DUKE ULUR DINJITETIN NJERËZOR, SI NË ATË TË KAFSHËVE, QË PRESIN THËRRIMET QË BIEN NGA TRYEZA E ZOTËRINJVE.

në konsideratë se si varfëria e dëmton dinjitetin njerëzor.

Turpi, mungesa e vetëbesimit dhe vetëvlerësimi i ulët mund të ndikojnë negativisht në mënyrën sesi njerëzit shohin aftësinë e tyre për të ndikuar në ndryshimin.

Të qenit i varfër është romantik vetëm nëpër libra, realiteti bardh e zi nuk lë vend për fantazi, këtu personazhi është i lodhur i drobitur, i dorëzuar para agimit të ri. Varfëria është prind i revolucionit dhe krimit, është e lehtë të kesh parime kur je i pasur por e rëndësishme është të kesh parime kur je i varfër, edhe pse varfëria ta ul kokën, dinjiteti nuk ta lë ta varësh atë. “Të jesh lypës nuk është turp, por kjo është e vetmja gjë e mirë që mund të thuhet për atë”.

Nëse nuk mundesh të ndihmohesh që jetët e tyre të marrin formë dhe jetë, të paktën mos i fyej, mos i injoro, ata nuk zgjedhën vetë, jeta i zgjedhi ata, mbase i pa më të fortë për të përballuar këtë sfidë.

Kjo pjesë e rëndësishme e shoqërisë në rrugëtimin tonë të përbashkët duhet parë me kujdes dhe dashuri, sepse kjo rrugë destinacionin final e ka të njëjtë.

Të gjithë heshtim para varfërisë, të dobët për të mos luftuar.



“Halili dhe Hajrija”, baleti i parë shqiptar në rrugëtimin e tij 60-vjeçar

Vepret e bukura i mbijetojnë kohës dhe janë pasuri e madhe e popullit. E tillë është vepra “Halili dhe Hajrija”, që përveç vlerave muzikore dhe estetike, ruan edhe vlerën e rekordeve historike, pasi është i pari balet shqiptar.

“Halili dhe Hajrija” është kompozuar nga kompozitori Tish Daija, në moshën 36-vjeçare, kur ai ishte ende në fillimet e punës së tij si kompozitor dhe kur mungonte krijimtaria shqiptare në këtë gjini. Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit, kishte një trupë balerinësh, por nuk kishte repertor vendas, viheshin në skenë vetëm pjesë të huaja. Pra, sfida ishte e madhe.

Ishte 13 janari i vitit 1963, kur kompozitori Tish Daija, baletmaestri Panajot Kanaçi, dirigjenti Mustafa Krantja e një grup i madh artistësh, arritën të vënë në skenë baletin “Halili dhe Hajrija” një vepër baleti tërësisht shqiptare. Subjekti i baletit “Halili dhe Hajrija” mbështetet tek drama me të njëjtin titull, shkruar në vitin 1949 nga Kolë Jakova. Ajo pasqyron trimërinë e luftëtarëve të Malësisë së Madhe në ndeshje me pushtuesit turq, në shekullin XVIII.

Subjekti është marrë nga një këngë popullore shkodrane “Fryni era, u çil Taraba”, e cila këndohet edhe sot, që prej malësive të Veriut deri në Elbasan. Sipas dëshmimeve, kjo ngjarje është mjaft e vjetër, mund t’i referohet shekullit të XVIII, por Kolë Jakova i kishte vendosur ngjarjet rreth vitit 1700-1710. Në atë kohë sundonte në Shkodër Sulejman Pasha. Ky pashë ka çuar gjashtëmbëdhjetë ekspedita kundra malësorëve të Kelmendit, por malësorët ia prisnin rrugën për në Mal të Zi. Sulejman Pasha kërkonte të shtronte malësorët e malazetë, që nuk njihnin sundimin e tij. Malësorët e Kelmendit të Kuçit e të Shkrelit e kanë thyer vazhdimisht Sulejman Pashën, duke i shkaktuar shpeshherë dëme shumë të mëdha. Lidhur me këto ngjarje, është ndërtuar edhe historia, ku Hajrija, e



tradhtuar nga burri, i cili bashkëpunon me turqit, ka tradhtuar vëllezërit e saj, prandaj ajo vret burrin dhe përmes një drame të madhe vihet në dilemë për të vrarë edhe djalin. Personazhet turke, veç Sulejman pashës, janë të krijuara, kurse Halili, e motra, Musta e Bejta Sylja kanë ekzistuar me të vërtetë, po me këta emra (përveç emrit Hajrije, i cili është i sajuar). Edhe sot malësorët e malësisë së Shkodrës i kujtojnë me

krenari trimëritë e Halilit me shokë.

Kjo dramë u bë frymëzuese për kompozitorin e ri Tish Daija që të krijonte muzikën e më pas baletmaestri Panajot Kanaçi “ta vishte” veprën me lëvizje dhe shprehi koreografike, që do të interpretoheshin nga trupa e balerinëve të talentuar të Teatrit të Operas dhe të Baletit.

Baleti i kompozuar nga kompozitori Tish Daija dhe baletmaestër Panajot

Kanaçi, u dirigjua nga Mustafa Krantja. Solistët e baletit ishin Ganimet Vëndresha, Xhemil Simixhiu, Miltiadh Papa, Petrit Vorpsi, Zoica Haxho, Estref Shaqiri, Albert Janku dhe Ëngjëll Tërshana.

Krijimtaria e tij tek “Halili dhe Hajrija” flet shqip, që nga zgjedhja e materialit burimor, harmonizmi, orekstracioni, forma etj., flasin të gjitha vetëm shqip. Duke qenë baleti i parë shqiptar që vihej në skenë edhe përgjegjshmëria ishte e madhe. Me këtë vepër ishte bërë një punë shumë e madhe, për atë premierë, punohej natë e ditë. Pa filluar ende punën me provat në sallë, balerinët e artë të asaj kohë, jetonin me muaj e muaj me fabulën e tij, intrigën, muzikën, plastikën, lëvizjet, mimikën, sytë... Njëri kishte qejf të interpretonte Halilin, dikush tjetër Hajrijën, ndërsa dikush e pëlqente veten nën petkun e Bektash Agës... Narrativa e plotë e historisë së baletit, u kishte dhënë në duar atyre balerinëve të parë, një thesar të cilin ata punonin që ta ruanin e ta ekspozonin sa më bukur në sytë e publikut.

I paharruar ngelet interpretimi i balerinës Ganimet Vëndresha, Artiste e Merituar në rolin e Hajrijes. Ajo kishte nisur të frymonte me portretin e Hajries, një grua e fortë, e martuar me një burrë që tradhton vëllezërit e saj. Kjo gjë i jepte shumë dhimbje personazhit dhe në fund ka një monolog shumë interesant përpara djepit, ku ajo ka thikën në dorë dhe do të vrasë fëmijën, pjellën e tradhtisë.

Baleti “Halili dhe Hajrija” hodhi baza për krijimin e një tradite kombëtare. Kjo shfaqje u prit në mënyrë

të shkëlqyer nga publiku, duke dalë me qindra herë para spektatorit dhe duke marrë duartrokitje e vlerësime pa fund. Më 12 dhjetor 1973 u luajt për të njëqind e pesëdhjetën herë.

Ndërsa në 1983, u rivu në skenë, tashmë nga një kast balerinësh më të rinj. Krahas emrit të Llaqi Nakos, në rolin e Halilit, radhitet edhe ai i Ilir Kernit, ndërsa në rolet e tjera Albana Sulejmani, Pëllumb Agalliu, Hajdar Shtuni, Ludmill Çakalli, etj. Koreograf është sërisht Panajot Kanaçi.

Baleti “Halili dhe Hajrija” është shfaqur afro 300 herë në skenën e Teatrit të Operës dhe Baletit në Tiranë. Për të kanë punuar edhe koreografë të tjerë si Agron Alija apo Arjan Sukniqi. Janë dhëna pa fund shfaqje brenda dhe jashtë vendit, si në turnetë e Greqisë (1983), në Itali (1991) dhe në Festivalin “Vera e Ohrit” (2005).

Në Francë, ky balet është vënë në skenë me artistët e Teatrit të Operës dhe Baletit Clermond-Ferrand (1980), me koreograf Brice Leroux. Baleti është vënë në skenë gjithashtu edhe në Kosovë nga Ansambli i Baletit të Teatrit Krahinor të Prishtinës në vitin 1979.

Para një viti, që kjo punë të ruhet e paprekur, u bë e mundur që partitura të kompjuterizohet dhe të botohet e plotë, në 573 faqe.

Ndërkohë kompozitori Tish Daija, mbetet në historikun e muzikës shqiptare, si artisti që kompozoi muzikën e të parit balet në historinë tonë. Ai përfaqëson një nga ata pak kompozitorë, që mbeten në elitën e kompozitorëve më të shquar shqiptarë.

Mbrojtja e konsumatorit: Praktika manipuluese në internet u gjetën në 148 nga 399 dyqanet online të ekzaminuara

Komisioni Evropian dhe autoritetet kombëtare të mbrojtjes së konsumatorit të 23 Shteteve Anëtare, Norvegjisë dhe Islandës (Rrjeti CPC), publikuan rezultatet e një kontrolli ("pastrimi") të faqeve të internetit të shitjes me pakicë. Ky kontroll mbuloi 399 dyqane online të tregtarëve me pakicë që shesin produkte, duke filluar nga tekstilet deri te mallrat elektronike. Ai u fokusua gjithashtu në tre lloje specifike të praktikave manipuluese që shpesh dihet se i shtynjë konsumatorët të bëjnë zgjedhje që mund të mos jenë në interesin e tyre më të mirë, të ashtuquajturat "modele të errëta". Këto përfshijnë: kohëmatës të rremë të numërimit mbrapsht; ndërfaqet e internetit të dizajnuara për t'i çuar konsumatorët drejt blerjeve, abonimeve ose zgjedhjeve të tjera; dhe informacione të fshehura. Hetimi tregoi se 148 vende përmbanin të paktën një nga këto tre modele të errëta.

Komisioneri për Drejtësinë, Didier Reynders, tha: "Shqyrtimi ynë tregon se gati 40% e faqeve të internetit të blerjeve në internet mbështeten në praktika manipuluese për të shfrytëzuar dobësitë e konsumatorëve ose për t'i mashtruar ata. Kjo sjellje është qartazi e gabuar dhe kundër mbrojtjes së konsumatorit. Sot ne tashmë kemi mjete detyruese për të ndihmuar në trajtimin e çështjeve të tilla dhe u bëj thirrje autoriteteve kombëtare të përdorin kapacitetet e tyre zbatuese për të ndërmarrë veprime përkatëse dhe për të luftuar këto praktika. Paralelisht, Komisioni po shqyrton të gjithë legjislacionin e konsumatorit për të siguruar që ai është i përshtatshëm për epokën dixhitale, duke përfshirë vlerësimin nëse modelet e errëta mbulohen në mënyrë adekuate.

- 42 faqe interneti përdorin kohëmatës të rremë të numërimit mbrapsht me afate për të blerë produkte specifike;
- 54 faqe interneti i drejtuan kon-



sumatorët drejt zgjedhjeve të caktuara - nga abonimet tek produktet më të shtrenjta ose opsionet e dërgesës - qoftë përmes dizajnit të tyre vizual ose zgjedhjes së gjuhës;

- U zbulua se 70 faqe interneti fshehin informacione të rëndësishme ose e bënin atë më pak të dukshëm për konsumatorët. Për shembull, kjo përfshinte informacion në lidhje me kostot e dorëzimit, përbërjen e produkteve ose disponueshmërinë e një opsioni më të lirë. 23 faqe interneti fshihnin informacione me qëllim manipulimin e konsumatorëve për të hyrë në një abonim;

Spastrimi përfshiu gjithashtu aplikacionet e 102 faqeve të internetit të ekzaminuara, 27 prej të cilave gjithashtu vendosën të paktën një nga tre kategoritë e modeleve të errëta. Autoritetet kombëtare tani do të kontaktojnë tregtarët në fjalë për të korrigjuar faqet e tyre të

internetit dhe për të ndërmarrë veprime të mëtejshme nëse është e nevojshme, sipas procedurave të tyre kombëtare.

Përveç kësaj hapësire dhe si pjesë e përpjekjeve të tij më të gjera për të trajtuar modelet e errëta për të plotësuar punën e rrjetit CPC, Komisioni do të kontaktojë gjithashtu tregtarët në internet të identifikuar në një studim të vitit 2022 mbi praktikën e padrejta tregtare në mjedisin dixhital për t'u kërkuar atyre të korrigjojnë çështjet e identifikuar këtu.

Për më tepër, Komisioni po mbledh komente për tre direktiva që lidhen me mbrojtjen e konsumatorit, për të përcaktuar nëse ato sigurojnë një nivel të lartë mbrojtjeje në mjedisin dixhital: Direktiva e Praktikave të Padrejta Tregtare, Direktiva për të Drejtat e Konsumatorit dhe Direktiva për Kushet e Padrejta të Kontratës.

Siguria është më shumë se mbrojtja, thekson EESC

Në seancën plenare të janarit, KESE debatoi vizionin e BE-së "Busulla Strategjike" për sigurinë dhe mbrojtjen, duke vënë në dukje se siguria duhet kuptuar gjerësisht, shumë përtej mbrojtjes ushtarake. Politika civile dhe parandaluese e sigurisë duhet të plotësojë aftësitë e mbrojtjes ushtarake, me NATO-n që është ofruesi kryesor i sigurisë së BE-së. Shoqëria civile nuk duhet të jetë kalimtare në çështjet e sigurisë. Në fakt, siç u dëshmuua në luftën aktuale në Ukrainë, ajo mund të ketë një rol stabilizues në kohë krize.

Opinionin me iniciativë të KESE-së mbi Kompasit Strategjik të BE-së (SC), shpreh nevojën për një përkufizim më të gjerë, pasi koncepti aktual i sigurisë në KS është shumë i ngushtë. Siguria shkon përtej mbrojtjes së thjeshtë ushtarake. Në kohë kërcënimesh komplekse, hibride, koncepti i sigurisë duhet të zgjerohet për të përfshirë edhe aspekte të energjisë, transportit, sigurisë dixhitale, të ujit dhe ushqimit, sigurinë e qytetarëve dhe ndërhyrjet e huaja, tha raportuesi dhe anëtar i EESC, Christian Moos.

Paqja sociale dhe stabiliteti ekonomik janë parakushte të rëndësishme për jo dhunën. Këto janë aspektet themelore të jetës sonë, që na shqetësojnë të gjithëve. Kjo është arsyeja pse shoqëria civile duhet të përfshihet në debat dhe të kontribuojë në zhvillimin e strategjisë së sigurisë së BE-së, shtoi z. Moos.

Opinionin argumenton se, paralelisht me aftësinë kombëtare, planifikimin e mbrojtjes dhe prokurimin e përbashkët, BE-ja duhet të vazhdojë të investojë burimet e saj të kufizuara kryesisht në politikën dhe mekanizmat civilë për të mundësuar parandalimin e konflikteve. Këtu shoqëria civile mund të bëjë ndryshimin, nëpërmjet rrjeteve të saj sociale dhe ekonomike, së bashku me potencialin e saj të fortë për diplomaci publike dhe kulturore.

Shoqëria civile ka një rol kyç për të luajtur në arritjen e një qëndrueshmërie më të madhe ndaj sulmeve hibride dhe minimit sistematik të kohezionit dhe solidaritetit brenda dhe ndërmjet Shteteve Anëtare të BE-së nga fuqitë armiqësore.

Siç tha Peter Clever, anëtar i KESE-së dhe bashkë-raportues për opinionin: Aftësitë mbrojtëse pa vullnetin e shoqërive për t'i përdorur ato me vendosmëri do të ishin të paefektshme.

BE dhe NATO – një aleancë më e fortë për një të ardhme të sigurt
Kthimi i luftës në Evropë me agresionin e Rusisë kundër Ukrainës ka qenë një "thirrje zgjimi" për marrëdhëniet e BE-së me NATO-n. Aleanca nuk është vetëm një partner strategjik i BE-së, por garantuesi i vetëm i vlefshëm i sigurisë së Evropës. Në këtë kuptim, krijimi i Bashkimit Evropian të Mbrojtjes duhet të plotësojë NATO-n dhe jo të konkurrojë me të.

BE-ja dhe NATO-ja ende nuk e kanë eksploruar plotësisht potencialin e bashkëpunimit të tyre. Forcimi i shtyllës evropiane të sigurisë dhe mbrojtjes do të thotë forcimi i NATO-s. Kur flasim për rritjen e aftësive mbrojtëse të BE-së, nuk është për të konkurruar me NATO-n, por për ta plotësuar atë, tha zoti Clever.

Nëpërmjet opinionëve të tij mbi rëndësinë e lidhjeve transatlantike, EESC ka inkurajuar BE-në të zhvillojë një kuptim më të mirë të rëndësisë thelbësore të partneritetit transatlantik për NATO-n. Ky partneritet u riafirmua së fundmi me nënshkrimin e tretë të Deklaratës së Përbashkët për Bashkëpunimin BE-NATO, që synon forcimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të partneritetit strategjik midis dy organizatave.

Siç komentoi zoti Clever: Ne e kemi përdorur udhëtimin falas për një kohë të gjatë dhe tani është koha për të ndërthurur forcën tonë dhe për të tërhequr peshën tonë në Aleancë.



Lidhja e Evropës me tren: 10 shërbime pilot të BE-së për të nxitur hekurudhat ndërkufitare

Komisioni Evropian njoftoi mbështetjen për 10 projekte pilot për të krijuar shërbime të reja hekurudhore ndërkufitare ose për të përmirësuar ato ekzistuese. Projektet e përzgjedhura do të lejojnë veçanërisht lidhje shtesë treni midis qyteteve të mëdha të BE-së si Parisi, Amsterdami, Barcelona, Mynihu, Milano ose Roma. Disa prej tyre janë planifikuar të funksionojnë para verës.

Komisionerja për Transportin, Adina Vălean, tha: "Ndërsa kërkesa për lëvizshmëri të gjelbër po rritet, ne kemi nevojë që tregu hekurudhor të përgjigjet shumë më



mirë dhe shumë më shpejt, veçanërisht për udhëtime të gjata dhe ndërkufitare. Kjo është arsyeja pse Komisioni Evropian tani dëshiron të ndihmojë kompanitë hekurudhore krijonë lidhje të reja ndërkombëtare të trenave – ditën dhe natën – duke thyer barrierat e shumta për hekurudhat ndërkufitare. Pres me padurim të punoj me sektorin hekurudhor për t'i bërë këta 10 pilotë të suksesshëm dhe për të frymëzuar shumë të tjerë për të bashkoi."

Plani i Veprimit 2021 identifikoi pengesa për marrjen dhe funksionimin e shërbimeve hekurudhore ndërkufitare të pasagjerëve, të tilla si alokimet e kapaciteteve dhe koordinimi i dobët midis

menaxherëve të infrastrukturës. Shërbimet e sotme pilot do të shërbejnë për të ilustruar se si mund të kapërcehen këto pengesa ekzistuese, duke lejuar shfaqjen e shërbimeve të reja. Me mbështetjen e Komisionit të sotëm, operatorët dhe autoritetet hekurudhore do të jenë në gjendje të thyejnë barrierat e mbetura.

Këta 10 pilotë janë vetëm hapi i parë, duke synuar grumbullimin e përvojës së vlefshme, për projektet e ardhshme.

Komisioni tani do të ftojë ata që paraqitën projektet e përzgjedhura që të ndërmarrin hapat e parë për të nisur projektet e tyre.

79 vjet nga masakra e mbetur enigme

Masakra e 4 shkurtit të vitit 1944 në Tiranë ka mbetur një enigmë në lidhje me motivin dhe numrin e të vrarëve. Historiografia shqiptare ende debaton në lidhje me këtë ngjarje, teksa në ndihmë vjen edhe dokumentacioni britanik i kohës për motivin dhe realitetin politik të atyre ditëve të para të shkurtit, 1944.

Në një volum të dokumentacionit britanik në librin *Sekretet e Luftës*, zbardhet motivi dhe numri real i të vrarëve në “Masakrën e 4 shkurtit”. Në dosjen me kod HS 5/96, të Inteligjencës ushtarake të SOE, ka edhe një paragraf për ngjarjen e 4 shkurtit. Ndërkohë, për herë të parë zbardhen edhe lajmet në Radio Tirana, të cilat zbardheshin nga intelijenca britanike. Në përshkrimin e situatës politike dhe ushtarake, agjentët britanikë kanë dokumentuar motivin e masakrës. “Në datën 3 shkurt, një atentat i pasuksesshëm raportohet të ketë ndodhur për jetën e Xhafer Devës, Ministër i Brendshëm dhe një kolaboracionist i njohur.

“60 partizanë nga burgu i Tiranës janë masakruar si reprezalje”, thuhet në dokumentin britanik. Ky informacion britanik duket se përputhet edhe me deklaratat në kujtimet e të dërguarit fuqiplotë të Hitlerit në Shqipëri, Herman Nojenbaher.

Sipas tij, Ministrit të Brendshëm iu bë një atentat dhe një person i afërm dhe shoqëruesi i tij mbetën të vdekur. “Si personalitet antipod me Mehdi Beun, në qeveri, Ministri i Punëve të Brendshme, Xhafer Deva, shënohej nga komunistët si armik i përbetuar. Mbeti i pa plagosur nga një atentat, viktimë e të cilit pat rënë vetëm adjutanti i tij”, ka deklaruar Nojenbaher.

Ky atentat duket se ka qenë motivi kryesor për ngjarjen e rëndë të 4 shkurtit, kur vendi ndodhej në një nga kulmet e luftës civile. Ndonëse Xhafer Deva tentoi ta mbajë të fshehur faktin që atij iu bë një atentat, masakra u nxit edhe nga situata politike. Nëse i referohemi dokumentacionit britanik, edhe pse qeveria shqiptare ishte në kulmin e pushtetit të saj, pas Operacionit të Dimrit, krerët komunistë dhe të Lëvizjes Nacionalçlirimtare ndodheshin mjaft afër Tiranës dhe larg maleve, për t’u mbrojtur, mesa duket nga dimri dhe ndjekja gjermane.

Por, pavarësisht kësaj situatë të favorshme për qeverinë shqiptare, kryerja e atentatit ndaj Ministrit të fuqishëm të qeverisë së Rexhep Mitrovicës, ishte një goditje e rëndë për autoritetin e saj. Radio Tirana ka qenë media më aktive në Shqipëri në kohën e luftës, megjithëse raportimet e saj nuk janë ruajtur. Por Intelijenca britanike ka mbajtur shënim çdo lajm të Radio Tiranës. Kështu, çuditërisht, mungon një transmetim në datën 4 shkurt në ditën e ngjarjes. Qeveria e Tiranës, me përjashtim të Xhaver Devës, ishte e shokuar dhe e papërgatitur për reprezaljen dhe ky duhet motivi i heshtjes në Radio Tirana. Por, në datat 2, 3, 5 dhe 7 shkurt 1944, ndonëse të vrarët nuk përmenden, ka një gjuhë tepër të ashpër nga qeveria e Tiranës.

Por, një ditë më pas, në datën 5 shkurt, ka një raportim interesant pas masakrës. Prefektura e Tiranës lajmëroi të gjithë qytetarë për t’u paraqitur në qendrat e xhandarmërisë, për të regjistruar identitetin e tyre. Ky



raportim hedh dritë mbi faktin se numri i të vrarëve nuk dihej dhe me këtë rast Prefektura dhe shërbimi i Xhandarmërisë do të kryente kontroll dhe do



NË DOSJEN ME KOD HS 5/96, TË INTELIGJENCËS USHTARAKE TË SOE, KA EDHE NJË PARAGRAF PËR NGJARJEN E 4 SHKURTIT. NDËRKOHË, PËR HERË TË PARË ZBARDHEN EDHE LAJMET NË RADIO TIRANA, TË CILAT ZBARDHESHIN NGA INTELIGJENCA BRITANIKE. NË PËRSHKRIMIN E SITUATËS POLITIKE DHE USHTARAKE, AGJENTËT BRITANIKË KANË DOKUMENTUAR MOTIVIN E MASAKRËS. “NË DATËN 3 SHKURT, NJË ATENTAT I PASUKSESSHËM RAPORTOHET TË KETË NDODHUR PËR JETËN E XHAFER DEVËS, MINISTËR I BRENDSHËM DHE NJË KOLABORACIONIST I NJOHUR.

të shënonte edhe personat që mund të konsideroheshin si të vrarë. Në datën 7 shkurt, Radio Tirana lajmëroi se çdo shqiptar që mbështet komunistët dhe bashkohet me ta, rrezikon internimin e familjeve të tyre. Me sa dukej, lufta kundër njëri-tjetrit ishte në kulmin e saj. Edhe gazeta zyrtare e kohës, “Bashkimi i Kombit”, doli me një titull të fortë, si “gjaku don gjak”. Nga ana tjetër, në dokumentacionin e Prokurorisë së kohës janë regjistruar 13 viktima. Ky dokumentacion i rrallë hedh dritë në lidhje me motivin e të vrarëve më 4 shkurt, se vrasja e tyre ishte pjesë e një hakmarrjeje politike dhe që lufta civile ishte në një nga kulmet e saj. Kjo ngjarje e rëndë nuk ishte një rast i shkëputur, por pasojë e situatës së rëndë politike dhe luftës civile mes shqiptarëve. Ngjarja e 4 shkurtit prodhoi edhe lëvizje interesante mes kabinetit. Shumë prej tyre nuk ishin dakord me hakmarrjen e Devës, duke e cilësuar si të tepruar. Konflikti i Xhaferr Devës me kreun e Regjencës, Mehdi Frashëri, duke se tashmë kishte nisur hapur. Ky konflikt përfundoi në përçarjen e tyre dhe në largimin nga qeveria të Xhaferr Devës, ndonëse ai ishte i preferuari i gjermanëve.

Dosja tepër sekrete HS 5/96, Ref B8/1/PL/281, 17 shkurt 1944 Situaata në Shqipëri

Partizanët vazhdojnë të tregojnë shenja aktiviteti në zonën e Tiranës, ku besohet se ndodhet Komiteti Qendror i Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Në datën 3 shkurt, një atentat i pasuksesshëm raportohet të ketë ndodhur për jetën e Xhaferr Devës, Ministër i Brendshëm

dhe një kolaboracionist i njohur.

60 partizanë nga burgu i Tiranës thuhet se janë masakruar si reprezalje...

Departamenti i Tregtisë ka shpërndarë një dokument për të gjitha prefekturat, duke bërë me dije se të gjithë tregtarët duhet të kenë çdo transaksion të dokumentuar dhe, në rast kontrolli, ata duhet të jenë në gjendje të tregojnë të gjitha dokumentet që mund t’u kërkohen.

Qeveria i tërhoqi vëmendjen popullsisë shqiptare për të mos rënë viktimë e propagandës së huaj, e cila kërkoi të paralizojë çështjen kombëtare të Shqipërisë, me synimin për ta kthyer vendin në një viktimë të tyre. Interesi i shqiptarëve është të jenë të bashkuar përkrah qeverisë së tyre kombëtare. Shqipëria nuk ka krijuar tradhtarë, edhe pse shqiptarët janë të paveshur, pa këpucë, ushqehen me bukë e djathë, kanë qenë gjithnjë të bashkuar dhe tepër të kujdesshëm për lirinë dhe pavarësinë e tyre. Qeveria shqiptare është e bindur se shqiptarët nuk do t’i tradhetojnë kurrë traditat e tyre.

Qeveria shqiptare u tërhoqi vëmendjen për të fundit herë të gjithë atyre që bashkëpunojnë, simpatizojnë apo ndihmojnë terroristët dhe komunistët. Toleranca ka ardhur në fund dhe ata që veprojnë kundër interesave të vendit, do të ndëshkohen rëndë.

Detyra e të gjithë atyre që janë gënjer dhe kanë lënë shtëpitë është të rikthehen. Ministri i Punëve të Brendshme ka ngritur një komitet për të raportuar në lidhje me situatën në rajonin e Kosovës, Vlorës dhe Beratit.

Ata, gjithashtu do të hartojnë një listë të numrit të banorëve para pushimit italian, si dhe numrin aktual. Prefektura e Tiranës ka lajmëruar për të gjithë shqiptarët rezidentë, të përhershëm ose të përkohshëm, se duhet të paraqiten te qendrat e Xhandarmërisë të zonës së tyre, duke treguar dokumentet e identitetit. Nëse ndonjë do të kapet pa dokumentet e identifikimit, ai do të konsiderohet një element i rrezikshëm dhe do të arrestohet menjëherë.

Prefektura lajmëroi më tej:

1-Të gjithë shtetasit shqiptarë duhet të raportojnë në qendrat e Xhandarmërisë ku ata jetojnë, të marrin dokumentet e reja të identitetit.

2-Të gjithë të huajt duhet të paraqiten te qendrat e Xhandarmërisë, ku të marrin lejen e re të qëndrimit.

Kryeministri shqiptar, Rexhep Mitrovica propozoi dy ministrat e rinj në kabinet, për Arsimin dhe Punët e Jashtme. Ministrat e rinj kryen sot betimin. Qeveria Mitrovica, së bashku me elementët e rinj, do të jetë në punë për të zgjidhur problemet e mëdha që janë pezull prej një kohe të gjatë. Këto çështje kanë të bëjnë direkt me ekzistencën kombëtare. Ministri i Brendshëm paralajmëroi të gjithë ata që kanë lënë detyrimet dhe janë bashkuar me brigadat dhe me komunistët, se familjet e tyre rrezikojnë të internohen. Ministri i Brendshëm u dha urdhër të gjitha prefekturave për të kontrolluar të gjitha dyqanet e këpucëve dhe ata që kanë lëkurë të tepërt, ta deklarojnë para fundit të muajit.

MUNDËSIA JOTE TË BËHESH PJESË E FORCAVE SPECIALE, EJA TESTOHU!

Dëshironi të punoni në Repartin më elitë të Forcave të Armatosura Shqiptare, siç është Batalioni i Forcave Speciale në Regjimentin e Operacioneve Speciale?!

Keni vullnetin dhe guxim të sfidoni veten tuaj me stërvitje dhe trajnime, ku do të ndjeheni të vlerësuar më një trajtim financiar të shtuar, mbi vështirësinë e punës që bëni?!

Doni të profilizoheni në specialitete të ndryshme, me njohuritë më të mira për profesionin që do kryeni?!

Dëshironi mundësi të shumta trajnimesh dhe misionesh brenda dhe jashtë vendit, krah për krah me Forcat më elitare të NATO-s?!

Për të pasur të gjitha këto dhe jo vetëm, EJA BËHU PJESË E BATALIONIT TË FORCAVE SPECIALE TË REGJIMENTIT TË OPERACIONEVE SPECIALE!

Kandidatët që do të aplikojnë për të marrë pjesë në Kursin XIV Bazë të Forcave Speciale, të paraqiten pranë personelit të reparteve përkatëse, për të dorëzuar dhe plotësuar dokumentacionin e nevojshëm, ose ta plotësojnë atë te personeli i Regjimentit të Operacioneve Speciale. Regjistrimet hapen në periudhën 01-10 shkurt 2023.

Zhvillimi i testimit përzgjedhës do të jetë nga data 13-17 shkurt 2023.

Shpallja e kandidatëve fitues do të bëhet me datë 24 shkurt 2023.

Kriteret për regjistrimin e kandidatëve janë:

1. Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë.
2. Të ketë gjatësi trupore mbi 170 cm.
3. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm, pa tatuazhe, mangësi apo shenja që deformojnë pamjen.
4. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatitit B dhe C.
5. Të mos ketë probleme me zemrën, veshkat, mushkëritë dhe mëlçinë.
6. Moshë maksimale për aplikim është 30 vjeç.
7. Të jetë ushtarak aktiv i Forcave të Armatosura Shqiptare (Oficer, Nënoficer, Ushtar).
8. Kandidatët Oficerë të jenë me gradën N/ Toger-Kapiten.
9. Kandidatët Nënoficer të jenë me gradën N/ Tetar-Tetar.
10. Kandidatët Ushtar Profesional të jenë me gradën Ushtar I – Ushtar IV, me kushtin që të kenë kryer kursin SIB dhe SIA.

Dokumentet e nevojshme:

1. Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati, ku të përfshihet dhe arsyeja e ndjekjes së kursit.
2. Fotokopje e ID.
3. Të dhënat e personelit sipas formatit ushtarak të firmosur nga Shefi i Personelit të njësisë ku shërben.

Pikë kontakti:

Zyra e Personelit të Regjimentit të Operacioneve Speciale

Cel: 00355684846190

Tel: 532-1044

